

VENDIM
Nr. 106, datë 31.5.2024

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HYDROBORSH” SHPK, PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE, PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKIMIT) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 770/8 prot., datë 29.5.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë ‘Hydroborsh’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 56, datë 2.4.2024, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydroborsh” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) e aseteve të paluajtshme të saj për të garantuar shlyerjen e detyrimeve ndaj palës kredidhënëse “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a.

- Në vijim të sa më sipër, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 770/3 prot., datë 8.4.2024, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe informacionin/dokumentacionin e munguar apo të plotësuar pjesërisht nga ky aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 770/5 prot., datë 25.4.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se ka nevojë që të sqarohet/depozitohet përsëri dokumentacion për këtë aplikim, ndaj ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 770/6 prot., datë 20.5.2024.

- Në referencë të përcaktimeve të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, dokumentacioni që nevojitet të plotësohet më tej nga shoqëria është si vijon:

- lista e aseteve të paluajtshme me vlerën e secilit aset dhe vlerën totale, dokument i cili duhet të jetë i nënshkruar nga të gjitha palët që kanë nënshkruar dhe marrëveshjen paraprake të financimit (neni 7, pika 1, germa “h”);

- deklarata me shkrim të palës kredidhënëse, “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a., e cila të shprehë gatishmërinë e saj për të garantuar vijimin e veprimtarisë së licencuar në rast se ndodh transferimi i aseteve (neni 7, pika 1, germa “i”);

- listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt, nëse ka pasur të tilla (neni 7, pika 1, germa “j”).

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 7701/0 prot., datë 30.5.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit të saj. Në këto kushte dhe në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 2, të rregullores të sipërcituar dhe në mbështetje të përcaktimeve të nenit 67, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësojmë zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Hydroborsh” sh.p.k., me 30 (tridhjetë) ditë pune, me qëllim analizimin e dokumentacionit të depozituar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë pune afatin e vendimmarrjes së Bordit mbi kërkesën e shoqërisë “Hydroborsh” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Hydroborsh” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti